



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), të Ligjit, Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr- 28/2008”, nenit 11, 15 dhe 29, pika 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, konform, Vendimeve të Kuvendit Komunal në Suharekë të miratuar në vitin 2003, për ndarjen e shpërblimeve të cekura më poshtë, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, 31.05.2023, miraton këtë:

V E N D I M

Për miratimin e propozimeve të komisionit për dhënien e shpërblimeve “Emblema e artë”, “Skënderbeu” dhe mirënjohjen “13 Qershori”

Neni 1

Shpërblimi “Emblema e artë” i ndahet, *Shefki A. MUQA* nga Suhareka (postmortum).

Neni 2

Shpërblimi “Skënderbeu” i ndahet dëshmorëve: *Nysret B. GASHI* nga fshati Peqan.

Neni 3

Mirënjohja “13 Qershori” i ndahet këtyre të nominuarëve: 1. Sylejman Tahir Sylejmani nga fshati Sopot-Kumanov-Maqedoni e Veriut (postmortum), 2. Baki K. Aliaj nga fshati Maqitevë (postmortum), 3. Xhavit Rakip Hasani nga fshati Tanushë-Maqedoni e Veriut, 4. Haki H. Spahiaj nga fshati Samadrexhë, 5. Ramadan Shemsedin Gashi nga fshati Peqan.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 016-34860
Më datë 31.05.2023



Kryesuesi i Kuvendit

Mr. ec Bexhet KUÇI